



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

Nr. 2349 / Prot.
1

Tiranë, më 3.7.2020

URDHËR

Nr. 199, Datë 3.7.2020

PËR

**RIORGANIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË,
“BACHELOR” NË “SHKENCA POLITIKE/MARRËDHËNIE
NDËRKOMBËTARE”, ME PROFIL “POLITIKA DHE LEGJISLACIONI NË
BASHKIMIN EVROPIAN”, TË UNIVERSITETIT TË NEW YORK-UT TIRANË**

Në mbështetje të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe të neneve 35 dhe 73 të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Riorganizimin e programit të studimit të ciklit të parë nga “Bachelor” në “Shkenca Politike/Marrëdhënie Ndërkombëtare” me kohëzgjatje normale 4 vite akademike (8 semestra), në “Bachelor” në “Shkenca Politike/Marrëdhënie Ndërkombëtare” me profil “Politika dhe legjislacioni në Bashkimin Evropian”, me 180 kredite dhe kohëzgjatje 3 vite akademike (6 semestra), në gjuhën angleze, me formë studimi me kohë të plotë. Në përfundim të këtij programi studimi lëshohet diplomë “Bachelor” në “Shkenca Politike/Marrëdhënie Ndërkombëtare”, me profil “Politika dhe legjislacioni në Bashkimin Evropian”, në Fakultetin e Drejtësisë dhe Shkencave Shoqërore, në Universitetin e New York-ut Tiranë, referuar nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.
2. Veprimtaria akademike për programin e riorganizuar të studimit të ciklit të parë “Bachelor” në “Shkenca Politike/Marrëdhënie Ndërkombëtare” me profil “Politika dhe legjislacioni në Bashkimin Evropian”, fillon në vitin akademik 2020-2021.
3. Universiteti i New York-ut Tiranë të marrë masa që programi i studimit t’i nënshtrohet procesit të akreditimit, sipas afateve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

4. Universiteti i New York-ut Tiranë të zbatojë procedurat e aplikimit për regjistrimin e formës së diplomës së këtij programi studimi, pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe të përshtasë aktet e brendshme rregullatore, në zbatim të këtij urdhri.
5. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë ushtron kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucionin e arsimit të lartë, në zbatim të këtij urdhri.
6. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Përgjithshme Rregullatore dhe Përputhshmërisë për Arsimin, Sportin dhe Rininë në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe Universiteti i New York-ut Tiranë.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

Besa SHAHINI